



FSASH



SPASH



EI - NOT

# TE RRISIM INTERESIN PER SHKOLLEN

## TE ELIMINOJME PUNEN E FEMIJEVE

Botim i FSASH e SPASH  
Me kontributin e EI-NOT

Pergatiten per botim:  
Xhafer DOBRUSHI  
Stavri LIKO

Shtypi “KUMI”

## **HYRJE**

Broshura “ Te rrisim interesin per shkollen, te eliminojme punen e femijeve”, botim i FSASH dhe SPASH, me mbeshtetjen e drejtperdrejte te Federates Nderkombetare te Arsimit, EI, dhe te financuar nga Fondacionit Holanez, NOT, eshte nje perpjekje per te pergjithesuar nje experience te re ne kuadrin e angazhimit shumevjecar te te dy Sindikatave te Arsimit ne Shqiperi per rritjen e interesit per shkollen dhe eliminimin e punes se femijeve.

Tashme eshte e njohur se Sindikatat e Arsimit, SPASH dhe FSASH, dhe nje numer gjithnje e me i madh mesuesish, prej disa vitesh jane perfshire aktivisht ne veprimtari te programuara e sistematike per shmangien e braktisjes se shkolles dhe eliminimin e punes se femijeve. Por, sic del edhe nga materialet qe jane perzgjedhur dhe botohen ne kete permbledhje, veprimtarite dhe eksperiencat qe lidhen me kete Projekt per rritjen e interesit per shkollen dhe eliminimin e punes se femijeve, ndryshojne nga programet dhe veprimtarite e zhvilluara deri me sot, sepse:

Se pari, Projekti i zbatuar me sukses ne gjashte shkolla te rretheve Tirane, Elbasan e Korce, te cilit i referohen materialet e botuara ne broshure, nuk zhvillohet me kryesisht ne nivel qendror ose qarku apo rrethi, por fokusohet krejtesisht drejtperdrejt ne shkolle, duke punuar konkretisht, te gjithes bashku, sindikaliste, mesues, nxenes, prinder e partnere te tjere.

Se dyti, per here te pare ndertohet e zbatohet nje program pothuaj njevjecar, qe nuk synon ne pergjithesi nxenesit qe mungojne ne shkolle ose e braktisin ate, por fokusohet ne kategori te vecanta te ketyre nxenesve, sic eshte rasti me disa nga vajzat qe braktisin ose jane ne rrezik braktisjeje ne dy shkollat e Bathores, i nxenesve Rome me probleme te veshtira

ekonomike e sociale ne dy shkollat e Elbasanit, apo i nxenesve minoritare ne dy shkollat e Komunes se Liqenasit.

Materialet qe botohen ne kete permbledhje tregojne per orientimin e Sindikatave te Arsimit drejt nje veprimtarie me konkrete ne baze shkolle dhe individi per eliminimin e punes se femijeve dhe per vendosmerine e tyre per ta vazhduar pa nderprerje kete veprimtari edhe ne te ardhmen.

Pasqyrimi i aktiviteteve te zhvilluara ne kuadrin e ketij Projekti, evidentimi i angazhimit te nje numri te madh mesuesish e nxenesish ne keto aktivitete dhe ne punen konkrete me nxenesit e perzgjedhur, rezultatet e arritura dhe konkluzionet qe kane dale sidomos nga Tryeza permbyllese e zhvilluar ne Tirane, jane nje pervoje qe mund te sherbeje jo vetem per thellimin e metejshe me te kesaj pune ne keto shkolle, por edhe per zgjerimin e saj ne shkolle te tjera te ketyre rretheve dhe, me gjere akoma, ne rrethe te tjera te vendit.

Ne emer te organeve drejtuese te sindikatave tona, ne falenderojme Zevendes Sekretaren e Pergjitheshme te Federates Nderkombetare te Arsimit, EI, Janice Eastman, dhe koleget e EI, Donatella Montaldo e Wouter Van der Schaaf, qe inicuan dhe ndoqen nga afer zbatimin e ketij Projekti; falenderojme, ne te njejten kohe, te gjithe mesuesit, nxenesit e prinderit, si edhe drejtuesit e seksioneve sindikale te ketyre rretheve, per angazhimin dhe punen e devotshme qe bene gjate kesaj periudhe dhe per optimizimin e shprehur per rezultate edhe me te mira ne te ardhmen. Falenderojme, gjithashtu, drejtuesit shkollave, perfaqesuesit e Drejtorive Arsimore dhe te Ministrise se Arsimit dhe Shkences dhe Ministrise se Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, per kontributin e dhene ne mbeshtetje te zbatimit efektiv te ketij Projekti.

Xhafer DOBRUSHI  
Kryetar i FSASH

Bajram KRUJA  
Kryetar i SPASH

**Disa drejtime e objektiva te Projektit te FSASH e SPASH ne lidhje me parandalimin e largimeve nga shkolla, eliminimin e punes se femijeve dhe rritjen e interesit per shkollen nga ana e femijeve me pervesim te ulet te lendeve mesimore.**

Ne vijim te punes e tyre per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve, me mbeshtetjen e Federates Nderkombetare te Arsimit, EI, nepermjet Fondacionit Holandez NOT, Federata e Sindikatave te Arsimit dhe Shkences, FSASH, dhe Sindikata e Pavarur e Arsimit Shqiptar, SPASH, ndermoren nje angazhim konkret per te punuar me nxenesit qe kane braktisur shkollen ose jane ne rrezik per ta braktisur ate ne 6 shkolla, te rretheve Tirane, Elbasan dhe Korce, si hapi i pare drejt angazhimit me pune qe ne moshen e femijerise.



Ne kete kuader FSASH e SPASH, u fokusuan ne dy shkollat 9- vjecare te Bathores, ne Tirane, ne dy shkollat ku ka me shume nxenes nga komuniteti Rome “De Rada” dhe

“P. Xhuvani” ne Elbasan dhe ne dy shkolla ku mbizoteron komuniteti maqedonas ne Liqenas te Qarkut te Korces, ku u organizuan gjate ketij viti, periudha prill-dhjetor, disa veprimtari qe lidhen me parandalimin e largimeve nga shkolla, eliminimin e punes se femijeve dhe rritjen e interesit per shkollen nga ana e femijeve me pervetesim te ulet te lendeve mesimore.

Fokusimi ne keto shkolla eshte bere per aresyet qe vijone:

**Ne zonen e Bathores**, ku ne te dy shkollat 9-vjecare frekuentojne rreth 2 750 nxenes, krahas problemeve te tjera, ekziston edhe largimi i disa vajzave nga shkolla per shkak te mentalitetit konservator te prinderve, te cilet e konsiderojne te rrezikshme vazhdimin e shkolles, ne klasat e larta te shkolles 9-vjecare, kur ato jane te rritura fizikisht. Ne kete zone u perzgjedhen 50 nxenese, kryesisht vajza te kesaj kategorie, me te cilat u organizua nje pune konkrete, per te menjanuar rrezikun e braktisjes se shkolles, si edhe kthimin ne shkolle, ne rastet e largimeve prej saj gjate ketyre 2-3 vjeteve te fundit.

**Ne Elbasan**, u perzgjedhen dy shkollat, “De Rada” dhe “P. Xhuvani”, ku vijone rreth 1 250 nxenes, nje pjese e mire e te cileve nga komuniteti rome, te cilet perballen me shume veshtiresi qe kane te bejne, jo vetem me probleme ekonomike te familjeve te tyre, por edhe me qendrimet te diferencuara, jo rrale edhe diskriminuese. Ne keto shkolla u perzgjedhen 40 nxenes rome, me te cilet u punua konkretisht per t’i ndihmuar ata qe te integrohen sa me mire ne klasat dhe shkollat perkatese dhe ne shoqeri.

**Ne Korce**, u perzgjedhen dy shkollat e komunitetit maqedonas ne zones e Liqenasit ku vijojne rreth 340 nxenes, ku u perzgjedhen 40 nxenes, te cilet kane veshtiresi te vijojne rregullisht dhe sidomos te kene rezultate te larta ne mesime, vecanerisht per shkak te veshtiresive ekonomike e financiare te familjeve te tyre, duke u bere te gjitha perpjekjet qe kjo te kombinohej me plotesimin e disa kerkesave qe mesues e

nxenes te ketij komuniteti kane per tekstet ne gjuhen amtare, programet mesimore etj.

**Objektivat kryesore** te ketij angazhimi kane te bejne me rritjen e kontributit te sindikatave tona te arsimit dhe te faktoreve te tjere ne fushen e arsimit per parandalimin dhe eliminimin e braktisjes se shkolles dhe te punes se femijeve

Me kete synim u identifikuan rreth 130 nxenes ne rrezik per ta braktisur shkollen ose qe kane probleme me pervetesimin e programeve mesimore, me te cilet u organizua nje pune konkrete per t'i nxjerre ata nga kjo gjendje dhe per t'i vene ne rrugen e integritit te plote ne klasat dhe shkollat perkatese.

Per kete qellim u plotesuan edhe pyetesoret perkates, duke e vene theksin tek arsyet e kesaj gjendjeje dhe masat qe mund te merren per permiresimin e situates.

E tere kjo pune u kombinua me rritjen e ndergjegjshmerise per domosdoshmerine e arsimimit per te gjithë, si edhe me rritjen e rolit te mesuesve per uljen e numrit te nxenesve qe braktisin shkollen dhe angazhohen ne pune.

Per realizimin e ketyre objektivave ne kuadrin e ketij programi, **u ngriten dhe funksionuan disa grupe pune dhe u organizuan aktivite te shumta**, midis te cilave mund te permendim:

1. Ngritja dhe funksionimi i Komitetit te Monitorimit te Punes se Femijeve ne nivel kombetar, me pjesemarrjen e perfaqesuesve te sindikatave dhe te drejtorive arsimore te rretheve te perzgjedhura, ku ka marre pjese edhe perfaqesuesi i MASH. Ky Komitet formalisht u mblodh dy here, por ai ndoqi nga afer tere punen e bere gjate kesaj periudhe, duke percaktuar edhe masa suplementare ne rastet qe u pa e nevojeshme.

2. Percaktimi i Grupeve te Punes ne Shkollat e perzgjedhura dhe organizimi i funksionimit te tyre sipas

kalendarit perkates:

Ky ishte momenti me i rendesishem i programit dhe keto grupe ishin berthamat qe **grumbulluan rreth vetes mesuesit me aktive per te organizuar punen konkrete me nxenesit e selektuar si ne rrezik per te braktisur shkollen, e cila konsistente sidomos ne:**

- Plotesimi i pyetesoreve me te gjitha te dhenat per secilin prej tyre,

- Bashkepunimi me mesuesit kujdestare per problemet qe lidhen me vijimin dhe mbarevajtjen ne mesime,

- Rakordimi i punes me qeverine e nxenesve dhe komitetin e prinderve, per t'u ardhur ne ndihme ketyre nxenesve, edhe me ndihmen e nxenesve me te mire ne klasat perkatese,

- Organizimi i punes me prinderit dhe te afermit e tjere, ne rastet kur ka patur rezistence per t'i shkeputur ata nga shkolla,

- Trajtimi i ketyre problemeve ne organet e pushtetit vendor, per te pare mundesine e ndonje ndihme me vende pune ose me ndonje ushqim, ne rastet ekstreme,

- Me rendesi te vecante ishte rakordimi i gjithe kesaj pune me Drejtorite e shkollave dhe Drejtorite ose Zyrat Arsimore.

3. E tere kjo pune u parapri nga nje takim konsultues me pjesemarrjen e te gjithe pjesetareve te grupeve dhe mesuesve te angazhuar ne punen konkrete me nxenesit, me synim:

- Informimin mbi permbajtjen e programit dhe planin e punes,

- Informimin mbi objektivat e programit,

- Konsultimin mbi pyetesoret dhe metodat qe do te perdoreshin ne procesin e punes konkrete me nxenesit e perzgjedhur per te punuar ne kuadrin e programit,

- Kembimin e mendimeve mbi aktivitetet e planifikuara per t'u zhvilluar ne shkolla etj.



4. Organizimi ne secilen prej 6 shkollave te perzgjedhura, i nje Diskutimi i gjere (me pjesemarrjene e nxenesve te perzgjedhur, mesuesve te angazhuar ne keto aktivitete, perfaqesues te drejtorive arsimore, komunitetit etj) ne lidhje me:

- kerkesat dhe nevojat e ketyre nxenesve ne shkolle, ne familje dhe ne komunitet,
- integrimi i tyre ne shoqeri dhe
- roli i arsimit per te perballuar sfidat e jetes,

5. Organizimi, ne secilen prej 6 shkollave te perzgjedhura, i nje aktiviteti kulturor-sportiv me pjesemarrjen e ketyre nxenesve dhe te disa nxenesve te tjere, si edhe te mesuesve e perfaqesuesve te tjere, ne formen e nje konkurimi, duke e shoqeruar kete aktivitet me nje koktejl, ku u shperndane edhe cmimet per fituesit.

6. Organizimi, i nje nje Tryeze te Rrubullakte, me pjesemarrjen e nxenesve te perzgjedhur, te mesuesve qe kane punuar me ta dhe drejtuesve te dy sindikatave jo vetem nga keto tre rrethe, por edhe nga disa rrethe te tjera te angazhuara ne aktivitetet per eliminimin e punes se femijeve me synim:

- Kembimin e eksperiences se punes se bere gjate zbatimit te ketij programi,
- Evidentimin e rezultateve dhe paraqitjen e diskutimin e nje programi per vazhdimin e kesaj pune ne vijim,
- Perpunimin e disa konkluzioneve ne lidhje me angazhimin e MASH dhe te Drejtorive Arsimore ne lidhje me parandalimin e punes se femijeve ne rrethet dhe shkollat perkatese.

7. Pergatitja e emisioneve televizive ne rrethet perkatese dhe disa botimeve qe do te behen ne kete kuader, vecanerisht posterat dhe broshura permbledhese mbi aktivitetet dhe rezultatet.

Nuk ka asnje dyshim se rezultatet e zbatimit te ketij programi kerkojne nje bashkepunim efektiv midis nesh ne radh te pare, dmth sindikata, Ministri, drejtori arsimore, drejtori shkollash, si edhe me organet e pushtetit vendor dhe me organizata te tjera te prinderve, nxenesve dhe OJF te angazhuara ne kete fushe.

E rendesishme eshte arritja e synimeve te zbatimit te ketij programi te sherbeje si baze per nje pune te suksesshme ne vijim, jo vetem ne keto shkolla dhe ne keto rrethe, por edhe me gjere ne disa rrethe dhe ne shume shkolla te tjera ne rang vendi.

## **TRYEZE E RRUMBULLAKET**

### **Mbi angazhimin e sindikatave te arsimit per rritjen e interesit per shkollen dhe eliminimin e punes se femijeve**

Ne vijim te angazhimit te tyre per rritjen e interesit per shkollen dhe eliminimin e punes se femijeve, dy sindikatat shqiptare te arsimit, Federata e Sindikatave te Arsimit dhe Shkences, FSASH, dhe Sindikata e Pavarur e Arsimit Shqiptar, SPASH, organizuan ne Tirane, Tryezen e Rrumbullakte, me pjesemarrjen e perfaqesuesve sindikaliste, mesuesve, nxenesve e prinderve nga 6 shkolla te rretheve Tirane, (zona e Bathores), Elbasan dhe Korce, nje aktivitet ky permbylles i Projektit qe keto sindikata zbatuan gjate periudhes prill-dhjetor te ketij viti, me mbeshtetjen e Federates Nderkombetare te Arsimit, EI, dhe Fondacionit holandez, NOT.



Merrnin pjese, gjithashtu, kryetaret e FSASH e SPASH, Xhafer Dobrushu e Bajram Kruja, perfaqesues nga Ministria

e Arsimit dhe Shkences, nga Ministria e Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, nga ILO-IPEC ne Tirane, nga organizatat e punedhenesve etj.

Ne raportin qe mbajti ne emer te dy sindiktave te Arsimit, FSASH e SPASH, Kryetari i FSASH, zoti Xhafer Dobrush, vuri ne dukje punen konkrete qe kane bere sindikatat, ne bashkepunim me Drejtorite e Shkollave ne dy shkollat e Bathores, per shmangien e largimeve nga shkolla te vajzave te klasave te larta te arsimit 9-vjecar; ne shkollat "De Rada dhe "Ptoleme Xhuvani" ne Elbasan per integrimin e nxenesve te komunitetit Rom ne shkollat e ne shoqeri dhe ne shkollat e minoritetit maqedonas ne Liqenas e Gorice te rrethit te Korces, per rritjen e interesimit per shkollat dhe kapercimin e disa veshtiresive qe ata hasin ne pervetesimin e lendeve mesimore.

Mbi 50 mesues te ketyre shkollave moren ne kujdestari dhe punuan me mbi 130 nxenes, duke bere nje pune konkrete bazuar tek vecorite e secilit prej tyre, sipas te dhenave te pasqyruara ne pyetesoret e plotesuar qe ne fillim te zbatimit te ketij programi dhe duke perfshire ne kete pune edhe shoqe e shoke te klases se ketyre nxenesve, prinderit e tyre, perfaqesues te pushtetit vendore etj.

Frymezueset jane rezultatet konkrete te arritura, si rezultat i kesaj pune, duke u kthyer ne shkollat nje numer prej 18 femijesh, qe e kishin braktisur ate, duke dale nga rreziku i braktisjes se shkolles me shume se 32 nxenes te ketyre 6 shkollave, si edhe duke shenuar permiresime te dukeshme ne rezultatet ne mesime me shume se 24 prej tyre.

Drejtuesit e grupeve te punes ne nivel rrethi, Albina Pepo, Bukuroshe Shabani e Derall Tota, paraqiten punen e bere dhe rezultatet e arritura ne shkollat e rretheve perkatese dhe parashtuan nje sere problemesh e detyrash per ta vazhduar kete pune ne te ardhmen.

Frymezueset ishin sidomos diskutimet e mesuesve Dilaver Lena, Nadire Taka, Albina Kolthi, Cvetko Male e te tjere, te

angazhuar drejtperdrejt ne zbatimin e programit, te cilet kishin ardhur se bashku me disa nga nxenesit me te cilet ata kishin punuar dhe folen mbi punen e tyre, problemet qe kane hasur dhe eksperiencen e fituar ne kordinimin e kesaj pune edhe me partneret e tjere, si drejtorite e shkollave, organet e pushtetit vendor, komunitetin, prinderit dhe vete nxenesit.



Mesuesja Nadire Taka, duke e konsideruar si djalin e saj, nxenesin e komunitetit Rome, Erges Peqini, e falenderoi ate ne prani te pjesemarrësve ne Tryeze, per reflektimin pas punes qe ajo beri me te e me familjen e tij per t'iu rikthyer shkollës, pasi e kishte braktisur ate, duke vazhduar normalisht shkollen dhe duke u integruar plotesisht ne klase se bashku me te gjithë nxenesit e tjere.

Drejtori i Mardhenieve te Punes ne Ministrine e Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, Bujar Cani, Perfaqesuesi i Ministrise se Arsimit, Fatmir Bezati, dhe Drejtuesja e Njesise per Eliminimin e Punes se Femijeve

prane Ministrise se Punes, Shkelqesa Manaj, vleresuan angazhimin e sindikatave te arsimit dhe te mesuesve per kete ceshtje kaq te rëndesishme te shoqerise sone, si edhe rezultatet e arritura, duke premtuar mbeshtetjen e institucioneve qe ata perfaqesojne per zgjerimin dhe thellimin e metejshem te kesaj pune ne te ardhmen.

Konkluzionet e nxjerra dhe plani i veprimit i miratuar ne kete Tryeze, sigurojne vazhdimin e kesaj pune ne shkollat pjesemarrese ne kete program dhe mundesine e zgjerimit te saj edhe ne shkolla te tjera te ketyre rretheve e me gjere.

## **Te rrisim interesin per arsimim cilesor dhe eliminimin e punes se femijeve**

*Fjala hyrese, mbajtur nga Z. Xhafer Dobrushu ne Tryezen  
permbyllese te Projektit,  
EI-NOT, pergatitur se bashku me Z. Bajram Kruja*

Te nderuar pjesemarres te kesaj Tryeze,  
Tashme eshte i njohur dhe i vleresuar angazhimi i dy  
sindikatave te arsimit ne Shqiperi, FSASH e SPASH, per  
trajnimin dhe sensibilizimin e drejtuesve dhe anetareve te  
tyre sindikaliste ne qarqe e rrethe, per t'u perfshire aktivisht  
dhe per te dhene ndihmen tone ne zgjidhjen e nje problemi  
kaq madhor per shoqerine shqiptare, sic eshte arsimimi  
cilesor i femijeve dhe eliminimi i punes se tyre. Ky angazhim  
vazhdon prej me shume se 5 vjetesh dhe do te vazhdoje deri  
sa ky problem te zgjidhet.



Krahas disa projekteve dy vjecare ose me afat me te  
shkurter qe jane mundesuar me mbeshtetjen e Federates

Nderkombetare te Sindikatave te Arsimit, EI, te Sindikates Holandeze te Arsimit, AOb, te Konfederates Holandeze te Sindikatave, FNV, te Programit Nderkombetar per Eliminimin e Punes se Femijeve, IPEC, etj, para 8-9 muajve, u inicua programi per rritjen e interesit te femijeve per shkollen dhe eliminimin e punes se tyre. Ky program u mbeshtet nga Federata Nderkombetare e Sindikatave, EI nepermjet Fondacionit Holandez NOT.

Vecorite e ketij programi, ne krahasim me programet e tjera qe cituam me lart jane dy:

Se pari, ndryshe nga programet e tjera qe deri tani jane zhvilluar ne nivel kombetar dhe deri ne nivel qarku ose rrethi, programi per te cilin do te diskutoje sot kjo Tryeze u fokusua drejt per drejte ne shkollen, pra ne nivel shkolle, me mesues, nxenes e prinder konkrete, atje ku problemi ekziston.

Se dyti, programi mbajti parasysh jo nxenesit ne pergjithesi qe braktisin shkollen, por disa kategori te vecanta me specifikat e tyre perkatese.

Ne pershtatje me keto vecori dhe kritere, ne konsultim me bazen tone sindikale, kryesite e SPASH dhe FSASH per-caktuan 6 shkolla konkrete ne rrethet e Tiranes, Elbasanit dhe Korces, nga 2 shkolla per secilin rreth, ku do te zhvillohej ky program.

Kur flasim per vecori te nxenesve dhe shkollave qe u per-gjodhen kemi parasysh tre kategori nxenesish, nga radhet e te gjitha femijeve problematike:

1. Ne rrethin e Tiranes, u perqendruam ne dy shkollat 9- vjecare te Bathores, Bathore nr. 1 dhe 2. Ne keto shkolla vazhdojne arsimin e detyruar rreth 2750 nxenes, ndermjet te cileve ka shume prej tyre qe frekuentojne me nderprerje, qe braktisin fare shkollen dhe qe punojne ne forma e objekte te ndryshme te ndaluara per moshen e tyre. Por, me te gjitha keta femije ne kemi ndertuar nje program tjetër, ndersa ne kete rast zgjodhem nga te dy shkollat vetem 50 vajza



nxenese, me te cilat u punua konkretisht per te shmangur rrezikun e braktisjes se shkolles si dhe kthimin ne shkolle ne rastet e largimeve prej saj gjate 2-3 viteve te fundit. Vecoria e ketij grupi eshte se keto nxenese nuk eshte se nuk e duan shkollen as se kane shkaqe kryesore vetem ekonomike, sic eshte varferia, per t'u larguar prej saj, por shkaqet jane, ne radhe te pare, sinteze e nje opinioni te vjeter, frenues e shume te demshem per shoqerine, opinion qe mbartet nga zonat prej te cilave ato kane ardhe dhe qe i konsideron tashme te rritura, me nje fjale, sipas ketij mentaliteti, ato nuk e kane vendin ne shkolle, por duhet te mbyllen ne familje per t'u fejuar e martuar me vone. Dhe te mos harrojme se keto jane nxenese te klases se 7-te e te 8-te, por ne ndonje rast te vecante ka edhe nxenese te klases se 6-te. Kjo ndodh ne periferi te Tiranes me komunitete qe kane ardhur e jane vendosur ne Bathore per t'u integruar ne kryeqytet.

Nuk ka nevojte per shume argumente per te provuar se sa i rrezikshem eshte ky mentalitet dhe fenomeni qe ushqen ai, duke shkeputur nga rruga e shkolles, nga shanset per t'u arsimuar, duke u hequr mundesine per progres ne jeten personale dhe njekohesisht per te kontribuar ne progresin e shoqerise, dhjetra e dhjetra vajzave.

2. Ne rrethin e Elbasanit, u perqendruam ne shkollat 9 – vjecare “De Rada” dhe “ Ptoleme Xhuvani”, ku mesojne rreth 1.250 nxenes, nje pjese e konsiderueshme e te cileve jane te komunitetit rom, por edhe egjiptian, te cilet perballen me veshtiresi te medha ekonomike qe kane familjet e tyre, por edhe me qendrime te diferencuara, jo rralle edhe diskriminuese. Ne keto shkolla u perzgjodhen 40 nxenes te komunitetit rom, me te cilet eshte punuar nga mesuesit dhe shkolla, nga sindikatat, ne menyre konkrete per t'i ndihmuar ata qe t'i kapercejne keto veshtiresi dhe te integrohen sa me mire ne klasat ku mesojne, ne mjediset e shkolles dhe ne shoqeri.

3. Ne rrethin e Korces, u perzgjodhen 2 shkollat e Komunes se Liqenasit, ku banon komuniteti maqedonas dhe natyrisht nxenesit jane nga ky komunitet. Ne keto 2 shkolla nuk ekziston fenomeni i braktisjes dhe pothuaj as tendeca per te braktisur shkollen. Ketu veshtiresite dhe problemet jane te nje natyre tjeter, por qe sjellin si pasoje uljen e nivelit te pervetesimit te mesimeve, cenimin e cilesise. Ne keto 2 shkolla mesojne 340 nxenes. Ne konsultim me keshillat sindikale, me mesuesit dhe drejtorite e shkollave u perzgjodhen 40 nxenes, te cilet kane relativisht rezultate te dobeta, nje zbehje te interesimit per shkollen, qe vjen nga veshtiresite ekonomike qe perballojne familjet e tyre, por edhe nga veshtiresi qe vijne per shkak te cilesise jo te mire ose te mungeses se teksteve ne gjuhen ametare, te programeve mesimore, etj.

Ne kuadrin e ketij programi u mundesua qe te punohet me 130 nxenes te te tre kategorive qe permendem dhe u angazhuan ne punen me ta rreth 50 mesues. Synimi ishte qe ky kontigjent nxenesish te ndihmohet per t'i nxjerre nga kjo gjendje dhe per t'i integruar ne menyre aktive ne klasat dhe shkollat ku mesojne si dhe ne shoqeri.

Programi u ndertua dhe u zhvillua ne disa faza.

Fillimisht u percaktuan masat organizative. U ngrit nje komitet ne nivel qendror me pjesemarrjen e drejtuesve te te dy sindikatave, te perfaqesuesve te Ministrise se Arsimit dhe Shkences dhe te Drejtorive Arsimore Rajonale perkatese. Komiteti perpunoj nje plan te hollesishem masash per secilin rreth dhe per te gjitha fazat e zhvillimit te programit.

Me rendesi ishte ngritja e grupeve ne shkalle rrethi per te dy shkollat. Ne grupet e rretheve filloi faza e konkretizimit, duke analizuar gjendjen ne secilen shkolle. U percaktuan mesuesit qe treguan gatishmeri per te punuar dhe nxenesit emer per emer, me te cilet do te punonte cdo mesues. Ne kete faze u be nje pune pergatitore per te njohur mesuesit me kuadrin institucional qe trajton punen e

femijeve dhe per te rritur sensibilizimin e opinionit te te gjithë mesuesve te shkollës per t'u perballur me problemin.

Ne fazën e dytë u hartua një pyetsor, i cili u plotësua nga te gjithë nxenesit e perfshire ne program. Plotesimi i pyetsoreve, pergjigjetet e sinqerta dhe pergjithesisht te sakta te nxenesve u bene një ndihme e madhe per sindikatat, drejtorite e shkollave dhe vete mesuesit per te zbuluar me mire dhe saktësuar shkaqet qe i cojne keta nxenes ne rrugen e ndarjes me shkollen. Mbi kete baze, ne secilen shkolle, me një mase te madhe mesuesish, me nxenes dhe prinder u organizua diskutimi per keto shkaqe dhe u percaktuan masa per menjanimin e tyre.

Faza e trete ishte nga me interesantet. Ajo u konceptua dhe u zhvillua si një kompleks veprimtarish kulturore, artistike dhe sportive ne formen e garave midis nxenesve te te dy shkollave te secilit rreth. Veprimtarite sportive me lojera futbollit, volejbollit, basketbollit etj, veprimtarite muzikore me kenge e valle, vizatimet dhe recitimet terhoqen vemendjen e pothuaj te gjithë nxenesve te ketyre shkollave. Ne Bathore, p.sh., ne projekt ishte parashikuar qe ne keto veprimtari te merrnin pjese 50 nxeneset me probleme dhe 15 apo 16 mesuesit qe punonin e kujdesin per to. Por nuk ndodhi keshtu. Oret e aktiviteteve kulturore, artistike e sportive u kthyen ne një feste ne shkolle. Ne keto aktivitete moren pjese mbi 250 nxenes dhe rreth 40 mesues. Keshtu ndodhi edhe ne dy shkollat e Elbasanit dhe ne ato te Liqenasit te Korces. Ne keto veprimtari luanin e konkurronin bashke, pa asnje dallim, nxenesit e rregullt dhe me rezultate te larta ne mesime si dhe shoket e tyre qe, per një shkak apo një tjetër, kishin filluar te largoheshin nga shkolla ose ta braktisnin ate.

Aktivitetet kulturore, artistike e sportive paten jehone midis nxenesve, por edhe mesuesve per një kohe te gjate. Dhuratat modeste qe Sindikatat Qendrore te Arsimit u bene ketyre shkollave, sic ishin topa futbollit, volejbollit,

basketbolli, rrjeta etj, u vleresuan si nje mundesi per vazhdimesine e veprimtarive sportive, aq te nevojshme per t'i miqesuar femijet, per te sfiduar individualizmin dhe indiferentizmin dhe per te kultivuar e rrenjosur ndjenjen e solidaritetit midis femijeve, ate te rritjes se interesit per fatet e shokut te klases apo te shkollës, etj.

Nje moment i rendesishem i gjithë ketij programi ishte anketimi. Plotesimi nga vete nxenesit i pyetsorit qe pergatiti komiteti ne nivel qendror, zbuloi shume shkaqe qe ndikonin dhe ndikojne ne zbehjen e interesit dhe te deshires se shume femijeve per shkollen, deri ne ate mase sa shume prej tyre e braktisnin ose e braktisin fare ate.

Pergjigjet e sinqerta te nxenesve qe u anketuan per pyetjet se cilat jane marredheniet e tyre me shkollen dhe me mesimet, se cila ose cilat lende u pelqejne me shume, a gjeni mbeshnje kur ndodheni para veshtiresive dhe nga kush, nga mesueset apo nga shoket e klases, se a keni mesues apo mesuese qe u besoni dhe u shfaqni shqetsimet dhe problemet tuaja, nese po cilet jane keta, si e ndjeni veten ne komunitetin e klases, si i keni marredheniet me nxenesit e komuniteteve te tjera, a keni enderrime dhe synime ne jete dhe cilat jane ato dhe se fundi se a mendoni e besoni se ka zgjidhje per ta ndryshuar gjendjen ne te cilen ndodheni; zbulojne nje bote te tere te brendshme te ketyre femijeve, bote e kushtezuar nga veshtiresi te shumeta ekonomike, familjare, shoqerore, komunitare, por e ndikuar e kushtezuar jo pak edhe nga cilesia e sherbimeve qe ofron shkolla, nga niveli shkencor pedagogjik dhe morali i shume mesuesve, nga mungesa e theksuar e respektit dhe dashurise prinderore qe manifestojne ata ndaj nxenesve. Ne cdo shkolle, nga 1 deri ne 4 nxenes te anketuar jane pergjigjur se nuk i besojne asnje mesuesi dhe pjesa dermuese e te anketuarve pergjigjen se i besojne vetem 1 ose ne raste te rralla 2 mesuesve, megjithese neper klasat qe ata kane kaluar kane pase kontakte mesimdhenjeje me dhjetra mesues. Nuk jane te pakte

nxenesit qe pergjigjen se kur kane nevoje per ndihme te diferencuar ne mesime, kete ndihme nuk e gjejne tek mesuesi ose mesuesit e tyre.

Kjo zbulon dobesi e mangesi te theksuara te procesit mesimor edukativ ne shkolle, indiferentizem dhe mungese aftesish nga jo pak mesues ose mesuese. Duhet te thuhet hapur dhe me force se me kete qendrim dhe paaftesi te tyre, keta tipa, qe titullin mesues e mbajne ne paranteze, ne thonjza, dashur pa dashur, behen shkaktare dhe kane nje pjese te pergjegjesise per fenomenin e uljes se interesit e te deshires se shume nxenesve per shkollen, per mungesat ne oret e ketyre mesuesve, deri edhe per braktisjen e shkolles.

Sindikatat e Arsimit, keshillat sindikale ne shkolla kane arme te forta per ta luftuar kete te keqe. Ato kane ne radhet e tyre me dhjetra e dhjetra mesues shembullore, qe jane per nxenesit ne kuptimin e vertete te fjales nje prind i dyte, qe me aftesite e tyre profesionale, me shembullin dhe figuren e tyre, i afrojne femijte, jetojne me problemet dhe shqetsimet e tyre. Jane pikerisht keta mesues, nje pjese te te cileve i kemi sot midis nesh, qe jane perfshire vullnetarisht, deri tani pa asnje shperblim, ne punen fisnike per rritjen e interesit te femijeve per shkollen dhe eliminimin e punes se tyre. Ky shembull i shumices eshte i mjaftueshem per te shkundur koleget e tyre indiferente, per t'i terhequr ata ne kete aksion te madh dhe per te diferencuar te pandreqshmit. Kjo eshte nje fushe ku duhet te bashkeveprojne ne menyre te suksesshme, si partnere te vertete drejtuesit e arsimit te cdo niveli dhe sindikatat.

Pothuaj te gjithe nxenesit e anketuar jane pergjigjur se kane deshire te vazhdojne shkollen, por jane prekese e te dhimbeshme arsytet qe pershkruajne ata, aresye qe i detyrojne te largohen prej saj, sidomos te varferia dhe mungesa e prinderve. Ne keto raste vete ata propozojne zgjidhje, kerkojne ndihme, ndihmen e kerkojne nga mesuesit, nga sindikatat e mesuesve, nga shkolla dhe nga

organet e pushtetit vendor dhe nuk ka asnje dyshim se kjo ndihme u duhet dhene atyre, perndryshe parullat per te drejtat e njeriut, per te drejtat e femijeve, per shanse te barabarta mbeten vetem slogane.

Anketat perbejne nje objekt studimi me te thelluar nga Sindikatat Qendrore, nga organet drejtuese te arsimit dhe vecanrisht nga pushteti vendor. Te gjithë kerkesat qe preokupojne kete kategori nenesish jane te zgjidhshme.

Dhe ja, te nderuar pjesemarres, pas ketyre fazave qe shkurtimisht i parashtruam ne kete fjale hyrese dhe qe zgjaten me shume se 8 muaj ne keto 6 shkolla, sot jemi mbledhur ne kete tryeze te gjithë bashke, mesues sindikaliste, drejtues shkollash dhe te Drejtorive Arsimore Rajonale, nxenes dhe prinder, perfaqesues te punedhenesve, per te pare se cfare beme, cfare arritem dhe c'duhet te bejme me tej.

Ajo qe mund te themi qe ne fillim eshte se puna qe beme te gjithë se bashku ka dhene rezultatet e para. Konkretisht:

- Ne dy shkollat e Bathores nga 29 vajza qe kishin braktisur shkollen nga klasa e 6-te ose e 7-te para nje deri 3 vjetesh, u kthyen ne shkollë 9 prej tyre, te cilat tani frekuentojne rregullisht dhe jane te vendosura te mbarojne arsimin e detyruar 9 vjecar. Po keshtu, ne kete vit shkollor frekuentojne rregullisht edhe 21 vajza te tjera qe frekuentonin me hope dhe ishin ne rrezik per t'u larguar nga shkolla.

- Ne Elbasan, ne Shkollen " Ptoleme Xhuvani" nga 25 nxenes te komunitetit rom qe ishin perfshire ne projekt dhe qe perbenin rrezik per ta braktisur shkollen, 7 prej tyre kane dale plotesisht nga kjo gjendje dhe frekuentojne rregullisht dhe kane rezultate inkurajuese ne mesime. Ndersa ne Shkollen " De Rada" nga 20 nxenes qe u perfshine ne projekt, 4 prej tyre kane dale nga rreziku i braktisjes. Po keshtu, ne keto dy shkolla 9 nxenes qe pothuaj e kishin braktisur shkollen, tani jane kthyer dhe frekuentojne rregullisht.

- Ne Shkollat e Liqenasit dhe te Gorices 24 nxenes, nga 40 qe u aktivizuan ne projekt, kane dale nga gjendja dhe niveli i rezultateve minimale dhe tregojne nje interesim me te madh per nje nivel me te larte te pervesimit te dijeve. Gjate projektit keto dy shkolla u ndihmuan ne menyre konkrete per te vene ne rrugen e zgjidhjes disa probleme qe ndikonin drejt per drejt ne nivelin e pervesimit te mesimeve, sic jane permiresimi dhe botimi i teksteve ne gjuhen amtare, tekstet per lendet e tjera, interesimi per transportin e mesuesve dhe te nxenesve etj. Ketyre shqetsimeve u eshte celur rruga e zgjidhjes qe nga Ministria e Arsimit dhe tani nuk ka me pengesa per to.

Keto jane ne menyre fare te permbledhur disa nga arritjet me thelbesore qe ne mundem te realizojme gjate ketyre 8-9 muajve ne keto 6 shkolla. Por rritja e interesit per shkollen dhe eliminimi i punes se femijeve nuk eshte nje fenomen qe zgjidhet per disa muaj. Faktoret qe e ushqejne kete fenomen, sic e pame, jane te shumte dhe puna per uljen dhe eliminimin e ketij fenomeni perben nje proces, nje proces te gjate, qe kerkon forca, mjete dhe angazhim te vazhdueshem.

Kjo do te thote se ne, sindikatat e arsimit, jemi te vendosura qe te mos heqim dore nga puna e nisur. Ne nuk do t'i leme punen dhe perpjekjet tona ne mes te rruges, nuk do te mjaftohemi me ato rezultate qe arrihem, sepse nese nuk vazhdojme te ecim perpara do te rrezikojme e izolojme edhe arritjet e derisotme.

Kjo do te thote, gjithashtu, se ne, Sindikatat, do te vazhdojme te bashkepunojme e bashkeveprojme me punedhenesin, me Ministrine e Arsimit dhe Shkences, me Drejtorite Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore, me drejtorite e shkollave, duke kerkuar dhe dhene llogari para njeri- tjetrit, per rezultate te tjera me te larta dhe me te qendrueshme deri ne eliminimin e punes se femijeve dhe te shkaqeve qe ndikojne ne uljen e interesit per shkollen.

Ne, sindikatat e arsimit, ashtu sic eshte sanksionuar edhe

ne Kontraten Kolektive te Punes te nivelit te pare, se bashku me punedhenesin, me MASH dhe Drejtorite e Zyrat Arsimore, do te paraqitemi si nje pale e vetme per keto probleme para organeve te pushtetit vendor per te ndikuar dhe zgjidhur ato ceshtje qe varen nga keto organe, sic jane zbutja e varferise, rritja e punesimit, perdorimi me kritere te drejta te ndihmes ekonomike, etj.

Se fundi, ne do te bashkerendojme punen tone me organizatat joqeveritare, me institucionet e vendit dhe ato te huaja, qe jane te angazhuara per nje arsim cilesor publik, per shanse te barabarta, per mbrojtjen e te drejtave te femijeve dhe eliminimin e punes se tyre.



## **Detyra konkrete per realizimin e objektivave te Projektit**

*Nga mbledhja e Komitetit te Monitorimit  
te Punes se Femijeve*

Ne vijim te aktiviteteve te programuara ne kuadrin e Programit me EI - NOT, u mblodh Komiteti i Monitorimit te Punes se Femijeve, i cili ndjek nga afer aktivitetet qe zhvillohen ne 6 shkolla te rretheve, Tirane (Bathore 1 dhe 2), Elbasan (De Rada dhe Ptoleme Xhuvani) dhe Korce (Liqenas dhe Gorice).



Ne kete mbledhje ku merrnin pjese, pervec anetareve te ketij Komiteti, perfaqesues te seksioneve sindikale te ketyre rretheve, edhe drejtuesit e dy sindikatave te arsimit, Z. Xhafer Dobrushki e Z. Bajram Kruja, si edhe perfaqesuesi i Ministrise se Arsimit dhe Shkences, Z. Fatmir Bezati, u be

nje bilanc i punes se bere dhe rezultatave te arritura deri tani dhe u percaktuan detyra konkrete per aktivitetet dhe objektivat qe do te realizohen ne vijim, sipas planit perkates te punes.

Ne fjalen e vete, Z. Xhafer Dobrushki beri nje prezantim te situates aktuale dhe theksoi se ne ditet e javet qe vijne puna e Komitetit dhe e rreth 50 mesuesve te angazhuar ne kete program do te jete shume intensive, duke u perqendruar sidomos tek veprimet konkrete me 130 nxenesit e perzgjedhur ne te 6 shkollat. Ai kerkoi nga perfaqesuesi i Ministrise qe te angazhohet per zgjidhjen e disa problemeve qe kane ngritur mesuesit dhe nxenesit e komunitetit maqedonas ne shkollat e Liqenasit e te Gorices (Korce), sidomos per sigurimin e mjeteve te transportit per nxenesit dhe mesuesit e fshatrave perreth, si edhe per shperblimin, sipas rregullave perkatese, te mesuesve qe kane pergatitur tekste specifike per dy shkollat e komunitetit maqedonas ne Liqenas e Gorice. Z. Bajram Kruja kerkoi qe detyrat ne kuadrin e ketij Programi duhet te vleresohen seriozisht nga secili prej mesuesve te angazhuar, duke siguruar nje bashkepunim sa me te mire edhe me Drejtorite Arsimore dhe organet e pushtetit lokale, per plotesimin e kerkesave qe kane nxenesit dhe mesuesit e ketyre shkollave.

Perfaqesuesit e sindikatave ne Komitet, Shaban Duka, Derall Tota, Bukuroshe Shabani, e Pellumb Agolli shprehen angazhimin e tyre dhe te mesuesve te shkollave perkatese per t'i ndjekur dhe realizuar sipas programit, aktivitetet dhe objektivat e percaktuara. Ata, se bashku me perfaqesuesin e DAR te Korces, Mirdash Pupa, vleresuan punen e bere nga dy sindikatat per botimin e paketes SCREAM dhe te Manualit mbi Arsimin Jo-Formal, si edhe per kualifikimin profesional te mesuesve, gje qe i sherben drejtpedrejt, jo vetem arsimit cilesor, por edhe mbrojtjes se femijeve dhe eliminimit te punes se tyre.

Perfaqesuesi i Ministrise, Zoti Fatmir Bezati, shprehu

gatishmerine qe te angazhohet ne Ministri dhe te bashkohet me drejtuesit e sindikatave per te marre pjese ne takimet qe do te organizohen se shpejti me grupet e punes ne keto shkolla, per te njohur me nga afer gjendjen dhe per te ndikuar ne zgjidhjen e problemeve.

Komiteti miratoi programin e aktiviteteve te ardhshme, sipas te cilit, takimet e grupeve do te zhvillohen ne datat 20 (Elbasan), 21 (Korce) dhe 24 shtator (Tirane), ndersa aktivitetet kulturore e sportive ne datat 22, 23, 24 tetor.

Keto aktivitete do te paraprihen nga puna konkrete per-gatitore me nxenesit, botimi i dy posterave dhe organizimi i emisioneve televizive te posacme mbi angazhimin e sindikatave e te mesuesve per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve.

## **Diskutim i gjere me nxenesit dhe mesuesit e perfshire ne Projekt**

Ne kuadrin e zbatimit te Projektit me Federaten Nderkombetare te Arsimit, EI, dhe Fondacionin holandez NOT, FSASH dhe SPASH organizuan takime dhe diskutime shume interesante ne shkollat Nr. 1 dhe Nr. 2 ne Bathore, "De Rada" dhe "Ptoleme Xhuvani" ne Elbasan dhe Liqenas e Gorice ne zonen e komunitetit maqedonas ne Korce, ku moren pjese mbi 135 nxenes dhe 45 mesues te angazhuar per te punuar me ta nga afer, per t'i ndihmuar qe te integrohen me mire, jo vetem ne shkolle, por edhe ne komunitet.

Keto takime u paraprine nga nje pune e gjithanshme parapergatitore nga ana e grupeve te punes ne keto shkolla, e cila kishte te bente me evidentimin e nxenesve, organizimin e sistemit te monitorimit, pergatitjes se dokumentacionit te nevojshem etj.

Takimet u zhvilluan te ndare ne cdo shkolle, gje qe krijoi mundesine qe te diskutohet konkretisht ne lidhje me gjendjen, evidentimin e nxenesve e te problemeve me te cilat ata ndeshen, plotesimin e pyetesoreve, etj.

Vertete optimiste ishin diskutimet, sidomos ne shkollat e Elbasanit, ne Shkollen Bathore Nr.1 ne Tirane dhe ne shkollat e komunitetit maqedonas ne Korce, ku mesuesit folen hapur perpara nxenesve, duke shprehur angazhimin e tyre per t'i ndihmuar ata qe te vazhdojne rregullisht shkollen, te pergatiten me mire ne mesime, por duke kerkuar qe edhe vete ata te jene me aktive dhe t'u kerkojne prinderve qe te vazhdojne shkollen, ne vend qe te shesin ne treg, te dalin ne rruge ose te angazhohen ne pune te tjera.

"Une, tha drejtoresha e shkolles "De Rada" ne Elbasan, Kristina Luga, i konsideroj te dy nxenesit me te cilet punoj

drejtperdrejt si dy djemte e mi”, duke shprehur edhe bindjen se ata do te integrohen plotesisht ne klasat perkatese dhe ne shkollë, si gjithë nxenesit e tjere.

Vete nxenesit folen hapur, duke vleresuar shume angazhimin e mesuesve te tyre dhe duke kerkuar ndihme, vecanerisht nepermjet kontakteve me prinderit e tyre, por edhe nepermjet ndonje mundesie tjeter, per te lehtesuar veshtiresite ekonomike e financiare me te cilat perballen familjet e tyre, sepse, sipas tyre, kjo eshte njera nga aresyet kryesore qe prinderit u kerkojne qe te punojne jashte kohes se mesimit ose paralelisht me te.



Eshte e rendesishme qe disa mesues raportuan rezultate te mira, qofte edhe pas nje kohe kaq te shkurter qe ata jane duke punuar me keta nxenes. Shembulli me i mire eshte ai i mesuesit Dilaver Lena ne shkollën Bathore Nr. 1, i cili tha se, si rezultat i punes konkrete te bere nga ai, se bashku me nje grup nxenesesh, njera nga vajzat ishte kthyer ne shkollë, pasi e kishte braktisur ate disa jave me pare.

Ne keto takime u diskutua, gjithashtu, edhe ne lidhje me

aktivitetet e planifikuara per t'u zhvilluar ne vijim te zbatimit te ketij Programi dhe te gjithë vleresuan planin per organizimin e disa aktivitetëve kulturore e sportive ne forme garash midis ketyre shkollave.

Sidomos ne shkollat e Korçes, nxenesit dhe mesuesit vleresuan shume ate cfare po behet ne zbatim te ketij Programi dhe te gjithë, mesues e nxenes, shprehen angazhimin per te realizuar objektivat qe jane percaktuar ne kete kuader.

Ne kete komunitet u analizuan, gjithashtu, disa probleme qe kishin te benin me trajtimin e mesuesve e te nxenesve, nga ana e Drejtorise Arsimore Rajonale dhe nga vete Ministria, sidomos ne lidhje me pagesat e prapambetura qe nga shperblimi i fund vitit qe kaloi, disa pagesa te prapambetura per pergatitje e botim tekstesh, si edhe disa probleme qe lidhen me transportin e nxenesve nga fshatrat perreth, te cileve u duhet te bejne cdo dite distanca te gjata per te ardhur e per t'u kthyer nga shkolla.

Pjesemarrja e te dy kryetareve te FSASH e SPASH, Z. Xhafer Dobrushit e Z. Bajram Kruja, si edhe e perfaqesuesve te Drejtorive Arsimore ne keto takime, ishte nje kontribut i rendesishem, si baze per zgjidhjen e ketyre problemeve dhe realizimin e objektiveve te caktuara, ne kuadrin e zbatimit te ketij Projekti.

## **Aktivite te tjera ne zbatim te Projektit**

*Nga mbledhjet e dyta te grupeve te punes ne shkolla dhe Komitetit te Monitorimit*

Shume aktivite te organizuar ne zbatim te Projektit me EI-NOT, ne te 6 shkollat ku FSASH dhe SPASH jane te fokusuara, duke filluar nga dy shkollat e Elbasanit e Korces dhe me pas, edhe ne ato te Tiranes, (Bathore).



Te dy kryetaret e sindikatave, Xhafer Dobrushu dhe Bajram Kruja, moren pjese ne te gjitha keto aktivite. Perfaqesuesi i Ministrise se Arsimit dhe Shkences, Z. Fatmir Bezati, mori pjese ne mbledhjen e Komitetit te Monitorimit te Punes se Femijeve, organizuar ne ambientet e Ministrise, per shkak te situates, pas nxjerrjes se paligjshme te sindikatave nga zyrat e tyre ne Tirane, ndersa perfaqesues te drejtorive arsimore te ketyre rretheve moren pjese ne

takimet qe u zhvilluan ne disa shkolla.

Dy ishin ceshtjet kryesore qe u diskutuan ne keto takime:

1. Gjendja ne lidhje me punen konkrete qe eshte duke vazhduar me nxenesit e perzgjedhur. Mesuesit informuan se, bazuar ne problemet qe kane dale nga pyetesoret e plotesuar qe perpara pushimeve verore, ata po punojne me nxenes te vecante ne shkollat dhe klasat respektive dhe do te vazhdojne te punojne, jo vetem ne shkolla, por edhe jasht tyre, ne bashkepunim me koleget e tyre, sidomos mesuesit kujdestare, por edhe jasht shkolles, ne komunitet e deri ne familje, ne bashkepunim me partnere te tjere te angazhuar ne kete pune.

Atyre iu kerkua qe te shkruajne informacione te shkurtera mbi punen qe ata jane duke bere dhe rezultatet qe po arrijne, me qellim qe ato te jene si shembull, jo vetem per koleget e tyre ne shkollat perkatese, por edhe jashte tyre ne shkalle rrethi e me gjere. Disa shembuj pozitive jane bere tashme te njohura, sidomos ne shkollen "Ptoleme Xhuvani" ne Elbasan, ne shkollen Bathore Nr. 1, Tirane dhe ne shkollen e Liqenasit ne Korce, ku disa nxenes po e ndjekim me rregullisht shkollen dhe po arrijne rezultate me te mira ne mesime.

2. Pergatitja e aktiviteve te planifikuara ne shkollat e perzgjedhura. Me te rendesishme midis tyre ishin aktivitetet sportive dhe kulturore, planifikuar per t'u zhvilluar ne Elbasan me 22 tetor, ne Korce, me 23 tetor dhe ne Tirane (Bathore), me 24 tetor. Pas diskutimeve konkrete, u ra dakord qe ato te organizohen ne forme garash midis dy shkollave te cdo rrethi, me pjesemrren e te gjitha nxenesve te perzgjedhur, por duke perfshire edhe disa nxenes te tjere, sidomos ne Bathore, ku nxeneset e perzgjedhura jane vetem vajza, duke planifikuar te pakten tre aktivite sportive dhe po kaq kulturore, duke organizuar edhe shpalljen simbolike te fituesve ne nje koktejl qe do te organizohet me kete rast.

Grupe te vecanta pune, ku jane te angazhuar, gjithashtu,



te gjithë mesuesit e këtyre shkollave, ndoqen nga aferë përgatitjen e këtyre aktivitetëve.

Ne këto takime u diskutua, gjithashtu, edhe në lidhje me përgatitjen e Tryezës së Rrumbullakës, planifikuar për t'u organizuar më 14 dhjetor, ku do të diskutohet, do të nxirren konkluzione dhe do të përpunohet e miratohet një program pune për të ardhmen. Mendimi është që kjo Tryeze të organizohet në Tiranë, për shkak të ambienteve dhe të mundësive të pjesëmarrjes së përfaqësuesve të Ministrisë, të institucioneve të tjera, si edhe të medias qendrore.

Është i rëndësishëm fakti që në të tre këto rrethe, FSASH e SPASH po punojnë për parandalimin dhe eliminimin e punës së femijeve, edhe në kuadrin e Projektit me FNV, një faktor tjetër ky që siguron se kjo pune do të vazhdojë edhe pas përfundimit të Projektit të EI-NOT.

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, duke u informuar nga të dy kryetaret, në një takim që ata kishin ditët e fundit në ministri, mbi punën që kanë bërë e po bëjnë sindikatat e arsimit për eliminimin e punës së femijeve, ka vlerësuar angazhimin dhe rezultatet e arritura dhe ka premtuar me shumë mbështetje, edhe për problemet e tjera që janë ngritur gjatë takimeve me mesuesit dhe nxënësit në këto shkolla.

## **Aktivite te shumta kulturore dhe sportive**

Sic ishin planifikuar, aktivitetet kulturore dhe sportive, ne zbatim te programit me Federaten Nderkombetare te Arsimit EI dhe Fondacionin holandez NOT, u organizuan me pjesemarrjen e nxenesve te shkollave perkatese, ne Elbasan, (shkollat “Ptoleme Xhuvani” dhe “De Rada”, te henen, me 22 tetor, ne Korce, (shkollat Liqenas dhe Gorice), te marten, me 23 tetor dhe ne Tirane, (shkollat Bathore 1 dhe Bathore 2 ), te merkuren, me 24 tetor 2007.

Me shume se 225 nxenes, perfshire te gjithë nxenesit e perzgjedhur per te punar konkretisht ne keto shkolla, ne kuadrin e ketij Projekti, moren pjese ne me shume se 10 gara sportive dhe aktivite kulturore, duke perfshire futboll, volejball, atletike, terhqeje litari dhe lojra te tjera popullore, si edhe kenge, valle, recitime, piktura etj.



Te gjithë mesuesit e perfshire ne projekt, rreth 50, si edhe mjaftë mesues te tjere, kryesisht specialiste te ketyre fushave, ishin organizoret e ketyre aktiviteve, te mbeshtetur nga

drejtuesit e shkollave. Ne aktivitete moren pjese, gjithashtu, kryetari i SPASH, Bajram Kruja dhe Zv/Kryetari Defrim Spahiu, si edhe perfaqesues te drejtorive arsimore te rretheve perkatese.



Aktivitetet u zhvilluan ne fome garash midis dy shkollave te secilit rreth. Komisione te vecanta i ndoqen ato nga afer dhe percaktuan fituesit, te cilet u shpallen ne ceremoni te posacme te zhvilluara ne koktejlet qe u dhane nga dy sindikatat e arsimit me kete rast, duke dhene Kupen per shkollat me te mira, Diploma per ekipe dhe individe te dalluar, si edhe disa dhurata simbolike, si topa futbollit, voljebolli, basketbolli, hendbolli, rrjeta volejbolli, kuti shahu etj.

Vertete mbreselene ishte kur te gjitha pane te ishin pjesemarres ne keto aktivitete disa nga nxenesit qe e kishin braktisur shkollen ose po e ndiqnin ate me hope dhe ishin kthyer ne shkolle, si rezultat i nje pune konkrete qe kane bere te gjithe se bashku; mesues e nxenes, sic ishte rasti i nxeneses Daniela Lushnjari, e cila u nderua me Diplomen









ketyre aktiviteve ishte vleresuar shume seriozisht nga mesuesit, nga vete nxenesit dhe nga drejtorite e shkollave, gje qe, krahas te tjerave, eshte edhe nje shembull se cfare mund te bejne vete shkollat per organizmin e me shume aktiviteve te tilla, mbasi disa nga pjesemarresit u shprehen se ishte hera e pare qe shihnin nje konkurrence kaq te madhe ne aktivite te tilla.

## **PROGRAM**

### **Per Vazhdimesine e angazhimit te sindikatave te arsimit per rritjen e interesit per shkollen dhe eliminimin e punes se femijeve**

1. Federata e Sindikatave te Arsimit dhe Shkences, FSASH, dhe Sindikata e Pavarur e Arsimit Shqiptar, SPASH, shprehin vendosmerine e tyre qe, ne kuadrin e angazhimit te pergjithshem per zbutjen dhe eliminimin e punes se femijeve dhe uljen e numurit te nxenesve te arsimit te detyruar qe braktisin shkollen ose frekuentojne me nderprerje, te vazhdojne me tej punen e nisur ne 6 shkollat e rretheve Tirane, Elbasan dhe Korce, me synimin per te rritur interesin per shkollen dhe per te eliminuar punen e nxenesve.

2. Angazhimi i perbashket i SPASH dhe FSASH per vazhdimesine e projektit per rritjen e interesit per shkollen do te mbeshtetet edhe nga partneret dhe grupet e tjera te interesit, perfshire Ministrine e Arsimit dhe Shkences, Ministrine e Punes, Ceshtjeve Social dhe Shanseve te Barabarta, Drejtorite Arsimore Rajonale te Qarqeve Tirane, Elbasan dhe Korce, Organizatat e Punedhenesve, te drejtorite e shkollave perkatese dhe seksionet sindikale te te dy sindikatave ne keto rajone.

3. Pjesemarresit ne Tryeze, duke marre ne konsiderate punen e bere ne periudhen prill – dhjetor 2007, te zhvilluar ne disa etapa dhe rezultatet e arritura, qe u evidentuan nga mesuesit, drejtuesit e shkollave, prinderit dhe vete nxenesit, vleresojne si arritje te kesaj faze:

- Ngritjen ne secilen shkolle te strukturave qe merren me nxitjen e interesit per shkollen, me motivimin e nxenesve



per rezultate me te larta ne mesime dhe per eliminimin e punes se femijeve.

- Angazhimin vullnetar te nje numuri gjithnje e me madh mesuesish nga secila shkolle dhe evidentimin e marrjen ne kujdestari prej tyre te nxenesve me problematike, duke punuar me ta dhe familjet e tyre dhe duke mundesuar qe shume nga keta nxenes te kthehen e integrohen ne shkolle dhe te frekuentojne rregullisht.

4. Ruajtja e ketyre strukturave, si dhe forcimi e konsolidimi i tyre, duke ruajtur kompozimin ekzistues me drejtues sindikaliste, drejtues te arsimit ne rajone e shkolla, mesues, prinder e nxenes dhe perfaqesues te pushtetit vendor, perben kushtin kryesor qe puna e nisur te mos mbetet ne gjysem te rruges dhe rezultatet modeste qe jane arritur te fuqizohen per te arritur synimin final.

5. Objekt i vemendjes dhe punes se ketyre strukturave dhe sidomos i grupeve te punes ne shkolla, do te jete evidentimi i shkaqeve qe kane cuar dhe cojne ne uljen e interesit te nxenesve per shkollen, per arsimimin e tyre, ne frekuentimin me hope ose braktisjen e shkolles dhe perfshirjen ne pune te rrezikshme dhe te ndaluara per moshen e tyre. Ne baze te anketave dhe te pergjigjeve qe kane dhene vete nxenesit, grupet e punes dhe mesuesit qe punojne drejt per drejt me nxenesit problematike duhet t'i vleresojne dhe klasifikojne keta faktore, per t'u perqendruar ne eliminimin e atyre faktoreve qe ndikojne me shume ne kete fenomen.

6. Ne nje faze te dyte te ketij projekti qe duhet te shtrihet gjate gjithë vitit 2008, duhet te mbahen parasysh ne menyre te vecante:

-Trajnimi i metejshem i mesuesve qe u angazhuan ne fazen e pare dhe qe punuan me nxenes konkrete.

-Mbajtja ne vezhgim nga secili mesues i angazhuar i kontigjentit te nxenesve me te ciliet punoi ne fazen e pare, ndertimi i nje pune te vecante me secilin dhe ndihma qe u duhet dhene atyre per te eliminuar ata faktore qe kane

ndikuar e ndikojne ne zbehjen ose humbjen e interesit te tyre per shkollen .

-Klasifikimi i grupit te nxenesve me te cilet punon nje mesues, duke ndertuar nje pune te vecante me ata qe jane permiresuar dhe nje program e pune tjeter me ata qe mbeten akoma problematike.

- Zgjerimi i rrethit te mesuesve vullnetare qe punojne me kete kategori nxenesish dhe perfshirja e te gjithë nxenesve problematike qe ka shkolla, nese ka te tille qe ne fazen e pare nuk jane perfshire ne vemendjen apo kujdestarine e mesuesve.

SPASH dhe FSASH do te bashkepunojne nga afer me MASH, Drejtorite Rajonale dhe Drejtorite e Shkollave, per te eliminuar mangesite qe ekzistojne sot ne keto shkolla dhe qe lidhen me plotesimin me mire te bazes materiale per aktivitete te vazhdueshme e cilesore sportive, muzikore e artistike. Nga anketimi i bere dhe nga aktivitetet e zhvilluara ne terren shihet qarte se keto veprimtari dhe keto lende i terheqin shume, siomos kete kategori nxenesish dhe ndikojne ne rritjen e interesit te tyre per shkollen, duke i integruar ata me mire ne komunitetin e nxenesve.

7. Sindikatat Qendrore, ne bashkepunim me Ministrine e Arsimit dhe Shkences, te gjejne e percaktojne mundesi dhe forma per te motivuar mesuesit qe vullnetarisht jane perfshire ne punen edukuese me nxenesit gjate dhe jashte procesit mesimor dhe i ndihmojne ata per t'u integruar me mire ne shkolle dhe per te braktisur jo shkollen por format e keqja dhe te rrezikshme te punes se tyre.

8. Drejtuesit e arsimit ne rajon dhe ne shkolla, por edhe mesuesit duhet te nxjerrin konkluzione nga preferencat qe kane shprehur nxenesit ne anketimin e bere per lende te vecanta dhe per mesues te vecante. Kjo lidhet drejt per drejt me rritjen e kerkeses ndaj secilit mesues per kualifikim profesional, per te mundesuar cilesi te larte ne arsimimin qe afron shkolla publike.

9. Synimi afatgjate i ketij programi te jete qe 6 shkollat e pilotuara dhe te perfshira ne kete nisme, te arrijne qe te mos kene asnje nxenes braktises ose qe punon, qe te gjithë nxenesit qe regjistrohen ne klasen e pare te mbarojne arsimin 9-vjecar te detyruar.

Tirane, dhjetor 2007

## PËRMBAJTJA

|   |           |
|---|-----------|
| Hyrje .....   | 3         |
| Disa drejtime e objektiva te Projektit te FSASH e SPASH ne lidhje me parandalimin e largimeve nga shkolla, eliminimin e punes se femijeve dhe rritjen e interesit per shkollen nga ana e femijeve me pervetesim te ulet te lendeve mesimore ..... | 5         |
| Tryeze e Rrumbullaket .....   | 11        |
| - <i>Mbi angazhimin e sindikatave te arsimit per rritjen e interesit per shkollen dhe eliminimin e punes se femijeve .....</i>  | <i>11</i> |
| - <i>Te rrisim interesin per arsimin cilesordhe eliminimin e punes se femijeve .....</i>  | <i>15</i> |
| Detyra konkrete per realizimin e objektivave te Projektit .....   | 25        |
| Diskutim i gjere me nxenesit dhe mesuesit e perfshire ne Projekt .....  | 28        |
| Aktivitete te tjera ne zbatim te Projektit .....  | 31        |
| Aktivitete te shumta kulturore dhe sportive .....   | 34        |
| Program per vazhdimesine e angazhimit te sindikatave te arsimit per rritjen e interesit per shkollen dhe eliminimin e punes se femijeve .....   | 40        |